



ABDURRAHIM BALLA

# MREKULLITË PROFETIKE

# Mrekullite Profetike

Falenderimi i takon vetem Allahut, paqja dhe bekimi I Tij qofshin mbi profetin e fundit, Muhamedin te cilin e dergoi meshire per njerezimin.

Dije se Allahu e ka dërguar Muhamedin salallahu alejhi ue selem tek njerëzit - në një kohë kur nuk kishte profet - mbasi i kishte urryer banorët e tokës përvec një pakice prej ndjekësve të librave (të mëparshëm) të cilët vdiqën të gjithë ose shumica pak para ardhjes së profetit salallahu alejhi ue selem.

Njerëzit në atë kohë ishin dy lloje:

1. Ose njeri i kapur pas librit (qiellor) i cili mund të ishte i devijuar dhe shfuqizuar ose ndjigjet një fe që ishte zhdukur e tëra ose një pjesë e saj.
2. Ose analfabet qoftë arab apo jo arab i cili adhuronte atë që i dukej e mirë duke menduar

se mund ti bënин dobi qoftë yjet, idhujt apo varret etj.

Njerëzit ishin në një injorancë tepër të madhe. Por më pas i udhëzoi Allahu me begatinë e profecisë së Muhamedit salallahu alejhi ue selem dhe me udhëzimin që solli. Ky udhëzim ishte aq i madh sa nuk mund të përshkruhet. I cili e kaloi dijen e atyre që dinin (para ardhjes së Muhamedit salallahu alejhi ue selem). Prandaj falenderimi i takon Allahut siç dëshiron dhe kënaqet.

Allahu i dha çdo profeti mrekulli qe tregojne vertetësinë e tij si profet qe ta besojne njerezit. Mrekulli qe nuk ka mundesi ti sjelle askush tjeter vec tyre.

Profeti ynë salallahu alejhi ue selem thote: "Cdo profeti i jane dhene mrekulli te mjaftueshe per ta besuar njerezit. Ndersa ajo qe m'u dha mua ishte shpallje (Kur'ani) prandaj shpresoj qe te kem me shume se ta ndjekes diten e Gjykiti" Transmeton Ahmed i Ibnu Maxheh, hadithi eshte i sakte.

Profeti yne ka pasur me shume mrekulli nga te gjithe profetet e tjere dhe mrekullite e tij jane me te medha se mrekullite e cdo profeti tjeter. Ato

jane aq te shumta sa nuk mund te numurohen. Ato tregojne veretesine e tij si profet, madheshtine e tij dhe graden qe ka ai tek Allahu.

Jo vetem kaq por dhe vete profeti salallahu alejhi ue selem ka qene mrekulli dhe meshire prej Allahut per njerezimin.

Abdullah Ibn Selam thote : Kur erdhi profeti salallahu alejhi ue selem ne Medine, shkova ta shoh (a eshte l vertete apo jo) . Kur e pashe fytyren e tij e kuptova qe fytyra e tij nuk ishte fytyre genjeshtari. Gjeja e pare qe tha ishte se tha: O njerez perhapeni selamin, ushqeni te varferit, viziton te afermit dhe faluni naten kur njerezit flene qe te hyni ne xhenet me paqe".

Nje prej mrekullive me te medha qe ka profeti jone salallahu alejhi ue selem eshte Kur'anii famelarte.

Mrekullite e tij nuk kane fund. Mrekulli gjuhesore, shkencore, shpirterore trupore etj. E ato qe ne nuk i dime jane me te shumta .

Ne vijim do permendim disa aspekte te mrekullive te Kur'anit i cili me gjithe keto mrekulli

eshte nje prej mrekullive te profetit tone salallahu alejhi ue selem

Aspekti i pare : Se ky Kur'an zbriti ne gjuhen arabe, ne nje kohe qe arabet kishin arritur graden me te larte ne letersi dhe elokuence. Aq sa mburreshin kush shkruante poezite me te bukura. Te cilat vareshin ne Qabe. Ne kete perjudhë erdhi profeti salallahu alejhi ue selem i cili ishte analfabet, as nuk shkruante e as nuk lexonte e u solli kete liber. I cili ishte ne gjuhen e tyre. I sfidoi me te . Allahu i Madheruar thote : "A thone eshte shpife! Thuaju: beni nje sure si suret e tij dhe ftoni ke te doni pervec Allahut ( qe tju ndihmoje ) nese jeni te vertete ".

Sepse ai ishte ne gjuhen e tyre dhe ata ishin te zotet e fjales sepse ishin teper elokuente dhe e njihnin shume mire poezine.

Por edhe pas 1400 vjetesh nuk munden ta bejne dot e as nuk kane per te mundur ta bejne dot deri diten e Gjykimit . Sfida vazhdon per çdokend qe nuk beson dhe deshiron te beje nje sure si suret e Kuranit .

Sepse ajo eshte fjala e Krijuesit e jo e krijeses dhe dallimi ndermjet saj dhe fjales se njerezve

eshte si dallimi ndërmjet Krijuesit dhe krijesave te Tij.

Aspekt tjeter: Fjalet e tij mahnisin krijesat. Mushrikët u mahnitën shume kur e degjuan Kur'anin dhe e kuptuan qe ai nuk ishte fjale njeriu. Por mendjemadhesia i ndaloi te besonin .

Jo vetem kaq por edhe xhindet u mahnitën nga Kur'ani . Allahu i madheruar zbriti nje sure te tere per ta ne Kur'an , suren Xhin , ku thote : " Thuaj , mua mu shpall se nje grup xhindesh degjuan ( kendimin e Kur'anit ) dhe u thane ( xhindeve ) ne degjuam nje Kur'an te çuditshem . Ai udhezon ne te drejten e ne nuk nuk i bejme Zotit tone shok " .

Ne hadithin e Islamit te Ebu Dherrit radiallahu anhu nder te tjera thote: Nuk kam pare poet me te madh se vellai im ka mundur 12 poetë në kohen e injorances njeri prej tyre isha edhe une . Ai shkoi ne Meke dhe i solli lajmin e profetit salallahu alejhi ue selem Ebu Dherrit . I thashe : cfare thone njerezit ? tha : Njerezit thone : ai eshte poet , fallxhor dhe magjistar . Po une i kam degjuar fjalet e fallxhoreve por fjalet e tij nuk i ngjajne fjaleve te tyre . Gjithashtu u perpoqa ta krahasoj me vjershat e poeteve por nuk perputhej dhe askush nuk mund t'i

perputhet, dhe asnë vjershë qe mund te vije me pas . Ai eshte i vertete e ata jane genjeshtare . Transmeton Muslimi .

Transmetohet qe Utbe Ibn Rabia kur e degjoi Kur'anin tha: o njerez ju e dini qe une nuk kam lene gje pa e mesuar pa e lexuar dhe pa e thene. Por po u them: Pasha Allahun degjova fjale qe nuk i kisha degjuar kurre . Ato fjale nuk jane poezi as magji e as fall.

Aspekt tjeter : Qe Kurani ka treguar disa lajme qe kane ndodhur pas ardhjes se tij . Te cilat nuk mund ti dije njeriu sepse kane te bejne me te ardhmen.

Si psh fjalë e Allahut ku i drejtohet profetit te Tij salallahu alejhi ue selem dhe shokeve te tij : Do te hyni ne xhamine e Haramit te sigurte me deshiren e Allahut ". E ndodhi siç tha Allahu i Madheruar .

Gjithashtu thote : " Elif Lam Mim , u munden romaket ne token me te ulet , por ata pas humbjes se tyre do fitojne pas disa vitesh " E me te vertete pas disa vitesh fituan romaket. Sic transmetohet ne hadithin e Ibn Abasit qe e transmeton Tirmidhiu. Hadithi eshte i sakte . Etj etj ajete te kesaj natyre.

Aspekt tjeter : tregimet e popujve te meparshem qe na i ka treguar Kur'ani. Te cilat nuk kane qene te njohura per Mekasit. E profeti salallahu alejhi ue selem nuk dinte te shkruante e as te lexonte qe ti merre keto histori nga libra te ndryshem. Duke shtuar edhe sfiden e Kur'anit ne keto sure ku tregohen keto histori te popujve te meparshem. Sepse keto jane sure si suret e tjera. Prandaj Kur'ani I sfidon njerezit te bejne sure si to. Prej ketyre historive qe nuk ishin te njohura per Kurejshet eshte historia e Jusufit alejhi selam. Ose historia e Muses alejhi selam, Dhul karnejnit, Banoreve te shpelles, Hidrit, Lukmanit etj.

Aspekt tjeter : Allahu ka premtuar se do ta ruaje Kur'anin e me te vertete deri me sot ai eshte sic ka qene. Fakt per te eshte se nuk gjen ndryshim ne asnje vend te botes ndermjet kopjeve te Kur'anit ne gjuhen arabe. Allahu i Madheruar thote : " Ne e zbritem perkujtimin (Kur'anin) dhe ne do ta ruajme ate".

Mrekullite e profeteve te meparshem jane zhdukur me vdekje e tyre. Ndersa mrekullia e profetit tone salallahu alejhi ue selem , Kur'ani vazhdon edhe sot e kesaj dite pas 1429 vitesh te jete i pa prekur ne asnje shkronje i ruajtur ne zemrat e miliona besimtareve te cilet ia

trashegojne kete mrekulli pasardhesve brez pas brezi sa te jete toka e çka ne te. Armiqtë e Islamit duan te gjejne rruge per ta hedhur poshte autenticitetin e Kur'anit me te gjithe fuqite e tyre por nuk munden se ai eshte i pa cënueshem i ruajtur nga Allahu i Madheruar . Keshtu, duan apo nuk duan ata vete deshmojne per vertetesine e tij. Sepse sikur te gjenin ane per ta hedhur poshte do e kishin bere. Por fakti qe nuk kane gjetur prej 1427 vitesh e deri me sot tregon qarte madheshtine e ketij libri i cili eshte nje nga mrekullite e profetit tone salallahu alejhi ue selem .

Aspekt tjeter : Kur'ani eshte sherim . Allahu i Madheruar thote : " Ne po te zbresim Kur'anin I cili eshte sherim dhe meshire per besimtaret "

Keshtu ka thene Allahu i madheruar . E ka thene te per gjithshme , dmth qe Kur'ani eshte sherim per çdo semundje jo vetem per semundjet shpirterore sic mendojne disa . Perkundrazi ai eshte sherim per semundjet shpirterore dhe trupore . Por ka nevoje qe ai qe e lexon te jete besimtar qe te beje dobi fjala e Allahut tek i semuri .

Besoj se nuk eshte e nevojshme te zgjatemi tek ndikimi qe ka Kur'ani tek te semuret me xhinde

ose magji. Sepse kjo eshte dicka e njojur tek te gjithe ata qe kane sadopak besim dhe e kane provuar vete kete ndikim te Kur'anit .

Por ajo qe vlen te permendet eshte ndikimi qe ka Kurani tek te semuret me semundje trupore qe kurohen nga mjeket .

1. Nje grup mjekesh ne nje nga spitalet e Florides bene nje kerkim mjeksor me ane te se cilit donin te nxirrnin se cilat jane ndikimet e Kur'anit ne trupin e njeriut , duke perdonur disa aparatura komjuterike teper te nderlikuara per te vene re ndryshimet fiziologjike tek nje numer pacientesh vullnetare. Prej te cileve kishte muslimane edhe jo muslimane e arabe e jo arabe . I ndane ne grupe. Njeri grup degjonte Kur'an, nje grup tjeter degjonte fjale te tjera arabisht me te njejtin kuptim. Ndersa grupi tjeter nuk degjonte asgje. Kjo gje u perserit 85 here tek te gjitha grupe.

Rezultatet ishin marramendese . Persa i perket grupit qe degjonte fjale te ndryshme arabisht edhe grupit tjeter qe nuk degjonte gje nuk u pa asje ndryshim ndersa grupi qe degjonte Kur'an kishte ndryshime te cuditshme duke pasur parasysh qe nje numer prej tyre qe ishin jo

arabe nuk e dinin qe ajo qe degjuan ishte Kur'an

U vu re tek keta njerez ndryshim ne perçimin e energjise trupore ne muskuj dhe ne lekure . Ndryshime ne qarkullimin e gjakut . Ndryshim ne rrahjet e zemres dhe ne temperaturen e lekures . Shkurtimisht kishte nje ndikim qetesues te qarte ne trup . Ky ndikim ishte ne sistemin nervor I cili ndikon ne te gjitha funksionet e trupit . Eshte e njohur ne mjekesi se tendosja e nervave ndikon negativisht ne imunitetine trupit . Gje qe dmth se Kur'ani ndikon ne rritjen e imunititetit te trupit me ane te ndryshimeve te qe permendem me siper

2 . Një numër dijetaresh kane shkruar rreth kurimit te te semureve me Kur'an duke shprehur edhe pervojet e veta ne kete fushe. Nje prej librave qe me ka bere pershtypje ne kete teme eshte libri I Dr Abdullah Sed'han I cili mban titullin " Si ta kurosh te semurin tend me Kur'an ". Ku ka permendur veç te tjerave edhe raste qe i ka hasur vet me te semure qe vuanin nga semundje te pa sherueshme per mjeket . Si semunde paralize e plote ose semundje te panjohura per mjeket ( e normalisht edhe te pakureshme per ta ) si edhe kancer. Te cilat i ka

kuruar me ane te leximit te Kur'anit edhe jane sheruar plotesish .

3. Une kam takuar edhe vet nje person qe kuronte njerez me Kur'an dhe me tregoi per veten e tij qe kishte sheruar te semure me kancer e me semundje te tjera te pasherueshme vetem duke I lexuar Kur'an .

Disa mrekulli te tjera te profetit tone salallahu alejhi ue selem .

1.Carja e henes . Allahu I Madheruar thote : " U afrua Kijameti e u ca hena . E nese (mosbesimtaret ) do shohin ndonje mrekulli do largohen e do thone : kjo eshte magji e vazhdueshme ".

Na tregon Allahu per carjen e henes ne kohen e shkuan dhe per largimin e mosbesimtareve nga kjo mrekulli . Kane rene dakord te gjithe dijetaret e tefsirit edhe ehli sunetit qe kjo ka ndodhur .

Transmetohet nga Ibn Mes'udi radiallahu anhu se ka thene : U ca hena ne kohen e profetit salallahu alejhi ue selem dy pjese nje pjese siper malit e nje pjese anash malit . Tha profeti salallahu alejhi ue selem : deshmoni . Transmeton Buhariu dhe Muslimi .

Transmeton Mesruku nga Ibn Mesudi se politesistet thane : ju beri magji Ibnu Ebi Kebshah ( kane per qellim profetin salallahu alejhi ue selem ) . Tha njeri prej tyre . Nese Muhamed i beri magji henes nuk ka mundesi ti beje magji gjithe tokes , prandaj pyesni ata qe vijne nga vende te tjera a e kane pare kete gje ? E keshtu bene kur erdhen disa njerez nag vende te largeta I pyeten e ata u thane se e kishin pare . Atehere thane politeistet kjo qenka magji e vazhdueshme .

Hadithet e carjes se henes I ka transmetuar vec Ibn Mes'udit , Enesi , Ibn Abasi Ibn Umer , Hudhejfe , Aliu , dhe Xhubejr Ibn Mut'im

Transmeton Buhariu nga Enesi radiallahu anhu se mekasit I kerkuun profetit salallahu alejhi ue selem tu tregonte nje mrekulli e ai u tregoi carjen e henes e cila u nda ne dy pjese .

2. Burimi i ujit nga gishtat e tij salallahu alejhi ue selem . Hadithet e burimit te ujit nga gishtat e profetit salallahu alejhi ue selem jane te shumta . I ka transmetuar ato nje numer sahabesh . Prej tyre Enesi , Xhabiri dhe Ibn Mesudi .

Transmeton Buhariu nga Salim Ibnul Xha'ad nga Xhabiri radiallahu anhu se ka thene : U eten

njerezit diten e Hudejbijes e profeti salallahu alejhi ue selem kishte para vetes nje ene ( te vogel lekure me uje ) prej te ciles mori abdes . Erdhen njerezit tek profeti salallahu alejhi ue selem e I thane : Nuk kemi uje tjeter vec ketij uji qe ndodhet ne enen tende . Atehere vendosi profeti salallahu alejhi ue selem doren e tij ne ene e uji filloi te dilte nga gishtat e tij si te ishte nje numer burimesh . I thashe ( Xhabirit ) sa ishit ate dite ? Tha : sikur te ishim nje qind mijë do na mjaftonte , ishim nje mijë e peseqind . Gjithashtu eshte transmetuar edhe nga Ubade Ibn Samit ne nje lufte tjeter edhe nga Umran Ibn Husejn . Keto Hadithe jane tek Buhariu , Muslimi , Tirmidhiu Daremieu etj .

3. Shumimi I ushqimit . Nje prej haditheve qe tregojne kete gje eshte hadithi I Ebu Talhes qe I tha Umu Sulejmit ( gruas se tij ) : degjova zerin e profetit salallahu aleji ue selem dhe mu duk I dobet dhe kuptova qe ai eshte I uritur , prandaj a ke gje per te ngrrene ? Tha : po , e nxorri disa copa buke prej elbi , i mbeshtolli me nje cope ( thote Enesi djali I saj ) e me nisi tek profeti . Shkova dhe e gjeta profetin salallahu alejhi ue selem ne xhami me njerez te tjere . Me tha profeti salallahu alejhi ue selem : A Ebu Talha te dergoi ? I thashe : po . Tha : A te dha ushqim ? I thashe : po . Atehere u tha atyre qe ishin ne

xhami , ngrihuni , U ngriten e une ecja para tyre derisa sa erdha tek Ebu Talha dhe I thashe . Tha Ebu Talha : O Umu Sulejm : Na solli profeti salallahu alejhi ue selem njerezit , cfare do tu japim per te ngrene ? Tha Umu Sulejm : Allahu e di me mire dhe I derguari I Tij . Doli Ebu Talha per te pritur profetin salallahu alejhi ue selem dhe hyri me te mbasi I dha selam profeti salallahu alejhi ue selem Ebu Talhes . Tha profeti salallahu alejhi ue selem : Eja o Umu Sulejm Sille ate qe ke per te sjelle . E solli Umu Sulejmi ate buken dhe e pregetiti ate pasi e thermroi . Foli profeti salallahu aleji ue selem disa fjale pastaj tha : lejo te vijne 10 veta per te ngrene . Erdhen hengren deri sa u ngopen e me pas dolen . E keshtu me rradhe dhjete e nga dhjete hanin deri sa ngopeshin e dilnin . Deri sa hengren te gjithe . Ata ishin 70 ose 80 veta .

Nder keto eshte edhe hadithi I Xhabirit diten e Hendekut qe hengren mbi nje mijë veta deri sa u ngopen . Transmeton Buhariu dhe Muslimi .

Nder te tjera eshte edhe hadithi I Semura Ibn Xhundub ne nje ngjarje tjeter . E transmeton Tirmidhiu dhe Daremiu hadithi eshte I sakte .

Nder keto hadithe eshte edhe hadithi I Abdurrahman Ibn Ebi Bekr te cilin e transmeton

Buhariu dhe Muslimi ne nje ndodhi tjeter te ngjashme .

Ngjarje te tilla jane te shumta te cilat jane transmetuar nga nje numer sahabesh disa prej te cileve I permendem . Nder ta edhe Seleme Ibnul Ekua , Ali Ibnu Ebi Talib , Enesi , Ebu Hurejre , Xhabiri etj . Shkurtimisht keto hadithe i transmetojne mbi dhjete sahabe dhe prej tyre I transmetojne shumefishi I ketij numri tabi'inesh dhe prej ketyre te fundit I transmetojne njerez te pa numert .

4. Pemet flasin dhe deshmojne se Muhamedi eshte I derguar I Allahut .

Transmetohet nga Ibn Umer se ka thene : Ishim me profetin salallahu alejhi ue selem ne udhetim . Nder kohe I afrohet nje fshatar profetit salallahua alejhi ue selem . I tha : O fshatar ku po shkon ? tha : ne shtepi . I tha : a te te tregoj dicka me te mire . I tha : cfare ? I tha : te deshmosh se nuk ka te adhuruar tejter vec Allahut dhe se Muhamedi eshte rob dhe I derguar I Tij . I tha : kush deshmon per vertetesine e kesaj qe thua ? I tha : ajo pema qe ndodhet ne ane te lugines . Thirre se ajo do te te per gjigjet . Erdhi pema duke care token deri sa qendroi para profetit salallahu alejhi ue selem . I

kerkoi profeti te deshmonte tri here dhe pema deshmoi . Me pas u kthye ne vendin e vet . Transmeton Bejhakiu , Daremiu , Taberani , Ebu Ja'la dhe Bezari . Hadithi eshte l sakte .

Hadithe te ngjashme me kete transmetohen nga Xhabiri , Ja'la Ibn Sejabeh , Ibn Mes'udi , Ibn Umer , Burjede , Ja'la Ibn Murre , Enes Ibn Malik , Ali Ibn Ebi Talib Ibn Abasi etj radillahu anhum .

5. Renkimi l trungut . Thote Xhabiri radillahu anhu . Xhamia ( e profetit salallahua lejhi ue selem ) ishte e mbuluar me deget e nje palme . E profeti salallahu alejhi ue selem kur mbante hutbe qendronte tek nje dege e saj . Kur iu be profetit salallahu alejhi ue selem mimberi ( u largua ) e ne l degjuam deges ze si zeri l deveve ( nga te qaret ) . Aq sa qane te gjithe njerezit qe ishin ne xhami kur e pane kete gje . ne nje transmetim thuhet se ajo qau nga qe e humbi dhikrin qe behej mbi te . E ne nje transmetim tjeter thuhet se profeti salallahu alejhi ue selem vuri doren mbi te e pushoi .

Haseni kur e tregonte kete hadith qante e thoshte o roberit e Allahut nje cope dru ka mall per profetin salallahu alejhi ue selem . Ju jeni me paresore per kete .

6. Profetit salallahu alejhi ue selem I japi selam edhe sendet etj .

Abdullah Ibn Mes'udi thote : ne e degjonim tesbihun qe bente ushqimi kur ne e hanim ( ne prezence te profetit salallahu alejhi ue selem ) . Transmeton Buhariu .

Transmetohet nga Xhabir Ibn Semura se profeti salallahu alejhi ue selem ka thene : Une njoh nje gur ne Meke qe me jepte selam para se te me vinte shpallja . Transmeton Ahmedi , Muslimi dhe Tirmidhiu . Etj hadithe te ngjashme me keto

.

7. Shpatulla I foli profetit salallahu alejhi ue selem .

Transmetohet nga Ebu Hurejre radillahu anhu se nje çifute I dhuroi profetit salallahu alejhi ue selem ne Hajber nje dele te pjekur ne te cilen kishte futur helm . Fillooi te hante profeti salallahu alejhi ue selem dhe shoket e tij e menjehere u tha : mos hani . Shpatulla ( e deles ) me tregoi se ishte e helmuar . Vdiq prej saj Bishr Ibn Bera . I tha profeti salallahu alejhi ue selem çifutes : pse e bere ? tha : Nese je profet ska per te te bere dem ndersa nese je mbret do te kishe vdekur prej saj . Transmeton Buhariu , Ebu

Daudi . Siç e transmeton kete hadith edhe Enesi gjithashtu .

### 8. Sherimi I te semureve .

Aliu radiallahu anhu diten e Hajberit kishte infekzion ne sy aq sa nuk shihte dot . Erdhi tek profeti salallahu alejhi ue selem e I treguan njerezit qe eshte I semure . E profeti salallahu aleji ue selem I beshtyu ne sy e u sheruan ne moment . Transmeton Buhariu dhe Muslimi .

Gjithashtu I beshtyu Plages qe kishte Seleme Ibnul Ekua ne kembe e u sherua ne vend . Transmeton Buhariu .

Hadithi I te verberit qe erdhi tek profeti salallahu alejhi ue selem dhe I keroi ti lutet Allahut ta sheroje ... u lut profeti salallahu alejhi ue selem dhe u sherua .

Gjithashtu ne kete pike hyjne edhe hadithet te cilat tregojne per disa lloje bimesh ose ushqimesh qe jane sherim . Prej e ketyre kemi hadithin :

a : hadithin e ujit te zemzemit . Thote profeti salallahu aleji ue selem : Zemzemi eshte ushqim

dhe sherim . Transmeton Ibn Ebi Shejbeh dhe Tajalisi . Hadithi eshte l sakte .

Gjithashtu ka thene per ujin e zemzemit : Zemzemi vlen per ate qellim qe pihet . Transmeton Ahmedi dhe Ibnu Maxheh . hadithi eshte l sakte .

Thote Ibnul Kajim : Kalova disa kohe ne Meke , u semura e nuk gjeja doktor dhe as ilaç per tu kuruar . Fillova te kurohesha duke kenduar fatihane ne ujin e zemzemit disa here dhe e pi ja . Gjeta prej kesaj sherim te plote . Aq sa ne shumicene rasteve kur semuresha mbeshtetesha vetem tek kjo menyre dhe me bente shume dobi . Shih Zad El Mead 4/162 .

Gjithashtu besoj se nuk ka musliman qe ka pire uje zemzemi e te mos l kete pare rezultatet e ujit te zemzemit vet . Jo vetem ne çeshtjen e sherimit por edhe ne pranimin e lutjeve .

b : Fara e zeze . Kjo fare eshte nje bime qe rritet vete pa ndihmen e dores se njeriut . Zakonisht rritet ndermjet bimeve te tjera . Ajo ne arabisht ka disa emra prej ketyre : fara e zeze , fara e begatshme etj .

Profeti salallahu alejhi ue selem ka thene per te : Nuk ka ndonje semundje vetem se tek fara e zeze eshte sherimi I saj vec vdekjes . Transmeton Buhariu dhe Muslimi . Gjithashtu jane transmetuar edhe hadithe te tjera me kete kuptim . Allahu ka thene ne Kur'an per profetin tone salallahu aleji ue selem : Ai nuk flet ne baze te deshires se vet , ajo ( qe thote ai ) eshte shpallje " .

Sot mjeket kane kryer kerkime te shumta ne vende te ndryshme te botes ne lidhje me vlerat kuruese te fares se zeze . Siç kane shkruar edhe libra rreth saj . Nje prej ketyre librave eshte libri me titull " Fara e zeze sherim per çdo semundje " te silin e ka shkruar profesor doktor Muhamed Nezar Dakar . Ku tregon nje numer kerkimesh qe kane bere mjeket ne lidhje me faren e zeze dhe rezultatet qe kane pasur keto kerkime . Po permend vetem titujt e kapitujve qe ka permendur doktori ne kete liber per te mos u zgjatur . Sherben si sherim dhe qetesim kunder infeksioneve te ndryshme . Sherben si ilac per llojet e gripit dhe ftohjes . Sherben per semundjen e trombozes . Sherben per kurimin e azmes dhe semundjeve alergjike . Siç kane vertetuar gjithashtu nje grup mjekesh se fara e zeze pakeson perqendrimin e kolesterolit , indyrerave dhe sheqerit ne gjak . Sherben ne

luftimin e mikrobeve . Ndihmon forcimin e imunitetit te trupit . E mbron njeriuun nga kanceri dhe zhvillimi l tij . Fara e zeze mbron stomakun nga ulçera etj etj .

Keto jane disa studime mjekesore rreth fares se zeze e mgjith kete mjeket vazhdojne akoma studimet rreth saj . E fjala e profetit salallahu alejhi ue selem ngelet e pa prekshme : Nuk ka ndonje semundje vetem se tek fara e zeze eshte sherimi l saj veç vdekjes .

c : Degezai Indiane dhe degeza e detit . ( El Ud el Hindi dhe El Uh el bahrij ) .

I ka permendur profeti salallahu alejhi ue selem ne disa hadithe . Nje prej tyre eshte hadithi qe thote : Perdoren i degezen e Indise se ne te ka shtate sherime . Transmeton Buhariu .

d : Hurma e Medines " Axhuah " . Profeti salallahu alejhi ue selem ka thene : kush ha ne mengjes 7 kokrra hurme axhuah nuk l ben dem ate dite as helmi dhe as magjija . Transmeton Buhariu .

e : Sena dhe senut dy bime per te cilat ka thenen profeti salallahu alejhi ue selem : perdoren i senane dhe senutin sepse ato jane

sherim per çdo semundje perveç vdekjes . Transmeton Ibn Maxheh dhe Hakim dhe tha ky eshte hadith I sakte . te njejtin mendim kishte edhe Dhehebiu ne lidhje me kete hadith edhe Albani .

f : Mjalti : Allahu ka thene ne Kur'an per mjaltin " ne te ka sherim " Nuk besoj se ka nevoje per te vertetuar nga ana mjekesore dobine qe ka mjalti se eshte mese I njohur .

Ndersa profeti salallahu alejhi ue selem thote per mjaltin : Sherimi eshte ne tre gjera : ne prerjen e hixhames , ne pirjen e mjaltit edhe ne hekurine nxekte por une e ndaloj umetin tim nga hekuri I nxekte . Transmeton Buhariu nga Ibn Abasi .

Une kam takuar nje profesor tefsiri ne arabine saudite I cili kishte bere nje zbulim ( nese do me lejohet ta quaj te tille ) te bazuar ne hadithet e mesiperme qe flasin per shtate sherimet qe I permendem me siper ( uji I zemzemit , fara e zeze , degeza e indise , axhuah , sena , senut , mjalti ) .

Beri nje perzierje te ketyre shtate sherimeve profetike me perqindje te caktuara ne baze te disa eksperimenteve qe I ka bere dhe nxorri nje

ilac te cilin e quajti " shtate sherimet " . Ky ilac u miratua nga ministria e shendetesise ne Arabi Saudite dhe sot shitet neper farmaci . Çudia nuk qendron ketu . Çudia qendron ne pershtypjet dhe rezultatet qe ka lene ky ilaç tek pacientet dhe njerezit qe jane kuruar me te . Te cilat ia kane treguar edhe vete prodhuesit . Ky I fundit I ka perhapur keto rezultate ne faqen e tij ne internet dhe ne broshura . Une e kam takuar personalisht dhe e kam pyetur per keto rezultate mbasi kam lexuar ne brochure qe jane sheruar edhe nga kanceri . Me tha : po me kane ardhur kater raste te ndryshme qe jane sheruar nga kanceri .

Njerin rast e ka shkruar edhe tek broshura . Nder te tjera ka pasur edhe raste njerez me azem qe jane sheruar , me veshka , renie flokesh etj . Siç ka ndikim shume pozitiv edhe tek te semuret me magji ose me sy .

Keto jane ato qe dime ne . Ndersa ato qe nuk dime ne lidhje me dobite e ilaçeve profetike jane edhe me shume .

g : Hixhamja : Transmeton Ibn Abasi nga profeti salallahu alejhi ue selem ka thene : Sherimi eshte ne tre gjera : ne prerjen e hixhames ne pirjen e mjaltit dhe ne hekurin e nxekte por une

e ndaloj umetin tim nga hekuri transmeton Buhariu dhe Ibn Maxheh .

Rezultatet qe kadhene hixhamja kane qene marramendese per mjeket . Prej ketyre rezultateve mund te permendim raste te semuresh me zemer qe jane sheruar nga hixhamja , te paralizuar , te semure me tension etj etj semundje te shumta . Te cilat I kane shtyre specilaistet muslimane te shkrujane edhe libra rreth ketyre sherimeve .

Keto ishin disa prej mrekullive te profetit salallahu alejhi ue selem shkrutimisht Sepse ne se do zgjateshim do na duhej nje vellim I madh ose me shume per ti perfshire mrekullite e tij qe ne i dime . Por mrekullite e profetit salallahu alejhi ue selem nuk kane te mbaruar e gjithmone njerezit do zbulojne mrekulli te reja .

Lus Allahun te na e forcoje besimin deri ne vdekje e ta beje dijen argument per ne jo kunder nesh .

Pergatitur nga

Abdurrahim Balla